

Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.27 Regj. Themeltar, Datë 05.06.2023 Regjistrimi, me:

Ankues: Partia Aleanca Progresiste, LZHK.

Kundër: Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve;
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Objekti: 1. Ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr.160, datë 29.05.2023, për shqyrtimin e kërkesës nr.74, datë 17.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për subjektin politik “Aleanca Progresiste LZHK”.

2. Kërkojmë detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të konsideruar të vlefshme rutinë për këshillin bashkiak, Kurbin, Qendra e Votimit nr. 0907, e cila i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.

Më datë **05.06.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Alma Kolgjoka (Relatore);**
- 2. Emona Muçi (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5. Marsela Dervishi (Anëtare).**

Relatorja e çështjes ka disponuar Vendimin “Për plotësimin e të metave të kërkesëpadsisë” dhe Urdhrin datë 05.06.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore”, duke caktuar datën **07.06.2023, ora 08:30**, për zhvillimin e seancës gjyqësore në: **ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë.**

Tiranë, më 05.06.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë